



Prishtinë, maj 2006 - mars 2008

Historiku i partisë

AKR-ja është certifikuar si Parti Politike më datën 03.05.2006 në Regjistrin për Regjistrim dhe Veprimtari të partive politike në Kosovë, Nr. 154/0506.

Emërtimi i partisë politike, Aleanca Kosova e Re, vjen nga organizata për lobim “The Alliance for New Kosova” që u themelua dhe u organizua nga Behgjet Pacolli në Uashington në vitet 2004-2006, për të lobuar për Pavarësinë e Kosovës. Të angazhuar në këtë lobim ishin edhe emra të njohur, shkencëtar, politikanë, analistë dhe aktivistë ndërkombëtarë si: Januz Bugajski, William Wolker e shumë të tjerë.

AKR, si parti politike, ekziston, që nga fillimi i vitit 2006, kur një grup ideatorësh me bindje liberal-demokrate në krye me biznesmenin shqiptar më të suksesshëm në botë, z. Behgjet Pacolli, të shtyrë nga nevojat imediate e qytetarëve të Kosovës të cilët po ballafaqoheshin me varfëri, papunësi e nëpërkëmbje, vendosën të formojnë këtë parti politike dhe përmes saj të sjellin ndërrime në filozofinë politike në Kosovë, duke shfrytëzuar gjithë mekanizmat institucional dhe demokratik. E gjithë kjo ishte me qëllim që qytetarit të Kosovës t’i kthehet dinjiteti. Ky dinjitet ishte cenuar nga politika e papërgjegjshme e një qeverisje që nuk merr për bazë interesat e qytetarëve, por interesat afatshkurta të klasës politike.

AKR beson se objektivat mund të arrihen, fillimisht përmes zhvillimit ekonomik dhe rritjes së shkallës së institucionalizimit të institucioneve shtetërore.

AKR, formoj degët e saja në tërë territorin e Kosovës dhe mbajti Kuvendin e Parë Zgjedhor me 26.11.2006, ku u zgjedhën e u legjitimuan strukturat udhëheqëse të saj.

Pas zgjedhjeve të 17 nëntorit 2007, Aleanca Kosova e Re u rëndit ndër tri partitë kryesore në Kosovë. AKR, është tashmë, partia më e madhe opozitare dhe përfaqësohet me 13 deputet në Parlamentin e Kosovës. AKR në vazhdimësi ka dëshmuar një rol konstruktiv si opozitë. Ajo ka arritur që për afro një vit, pas krijimit, të shtrij strukturat e saj në tërë territorin e Kosovës.

Struktura e partisë

-**Forumi Rinor** në kuadër të partisë politike, Aleanca Kosova e Re ekziston që nga themelimi i saj. Në fillim ishte një grup të rinjsh të cilin funksiononin si një Këshill Iniciues dhe që kishin për obligim të organizonin rininë në kuadër të AKR-së, në të gjitha degët e saj. Organizimi i forumit filloi më krijimin e nëndegëve, degëve dhe më 7 tetor 2007, u mbajt edhe Kuvendi i parë Zgjedhor i Forumit Rinor. Ky forum është shtrirë dhe funksionon pothuajse në të gjitha degët e AKR-së në Kosovë. Forumi Rinor deri më tani i ka të konstituuar 29 degë. Pra, mënyra e organizimit të Forumit Rinor është e ngjashme me atë të partisë, duke u organizuar në dy nivele: në atë lokal; në nëndegë dhe degë, dhe në nivelin qendror. Funksionimi dhe organizimi i Forumit është i rregulluar më dokumentet ligjore dhe politike të tij: si rregullorja e punës, rregulloret tjera të forumit si dhe programi i Partisë. Qëllimi i këtij forumi është që brenda AKR-së të këtë të organizuar rininë në shkallën më të mirë të mundshme, që në bashkëpunim me strukturat tjera të partisë t'i identifikoj nevojat dhe problemet e rinisë kosovare dhe në këtë mënyrë t'i mbrojë interesat e rinisë në të gjitha nivelet institucionale.

-**Forumi i Gruas i AKR-së**, është pjesë e strukturës politiko-organizative të partisë. Ai u themelua në kuvendin e tij të parë zgjedhur, të mbajtur më 24.11.2006 ku zgjodhën strukturat udhëheqëse të këtij forumi. Ky Forum ka shtrirje në tërë komunat e Kosovës në nivel të degëve dhe nëndegëve. Platforma e F.G. të AKR-së bazohet në Statutin Partisë dhe në Programin e saj. Ky forum paraqitet si një faktor shumë i rëndësishëm dhe me një rol kyç në politikën e AKR-së. Synim kryesor i F.G. së AKR-së është avancimi i pozitës së gruas në shoqërinë kosovare. Këto synime do të arrihen përmes politikave që krijojnë hapësirë për pjesëmarrjen e femrave në politikëbërje dhe në vendimmarrje, çka është një ndër kriteret për ndërtimin e një Kosove funksionale demokratike.

-AKR gjithashtu në kuadër të saj ka edhe **Forumit e Pensionistëve**, që ka për qëllim përmirësimin e gjendjes ekonomiko-shoqërore të kësaj klase, e cila ka kontribuar shumë në shoqërinë kosovare dhe nuk po gjen mbështetjen e merituar nga institucionet politike në Kosovë. Ky Forum ka degët në shumicën e komunave të Kosovës.

-AKR-ja ka rreth 30 degë në tërë territorin e Kosovës si vijon: Albanikë (Zveçan), Zubin Potok, Mitrovicë, Vushtrri, Podujevë, Obiliq, Fushë Kosovë, Prishtinë, Gollak, Lipjan, Ferizaj, Shtime, Kaçanik, Hani i Elezit, Kamenicë, Dragash, Prizren, Rahovec, Malishevë, Gjakovë, Deçan, Istog, Pejë, Klinë, Junik, Drenas, Skenderaj, Viti. Ndërsa, në diasporë në kuadër të AKR-së vepron "AKR Internacional" me qendër në Cyrih, që ka për qëllim përkrahjen e Diasporës në të gjitha dimensionet e saja.

Aleanca Kosova e Re